



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 8 prill 2011, në mbledhjen e XII (dymbëdhjetë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve nr. 31 dhe filloi në orën 11.10.

Mbledhjen e hapi z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Burhan Blakçori, z. Nebih Behluli, z. Arbresha Hetemaj , z. Radisav Peroviq , z. Jahë Lahu dhe z. Selver Rama.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe të ftuarit z. Halil Syla, Stacioni i policisë në Podujevë - Njësi për komunitete, z. Habil Sylejmani, Komanda Rajonale Kufitare Veriu – Lluzhan, z. Luaras Oseku, OSBE – Zyra rajonale në Prishtinë dhe z. Set Hejral, LMT – KFOR.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 7 mars 2011

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Vendimi për vënie në diskutim publik të propozim Rregullore për trajtimin e ndërtimeve pa leje

z. Nebih Behluli, nënvizoi, propozimet e Rregulloreve të cilat janë në rend dite të mbledhjes së sotme Kuvendi i Komunës i ka miratuar në parim dhe i ka vu në diskutim publik, akte normative të cilat janë të nevojshme për ngritjen e efikasitetit në lëmit përkatëse.

Ky vendim u mbështet njëzëri.

4. Vendimi për vënie në diskutim publik të propozim Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Podujevës

Vendimi njëzëri u mbështet.

5. Raport për vizitën e bërë komuniteteve pakicë në Podujevë, rruga “Ali Ajeti” dhe fshatrat Sfeçël, Batllavë e Orllan

z. Jahë Lahu, e paraqiti raportin dhe përveç tjerash theksoi, në rrugën “Ali Ajeti në Podujevë, më 18 mars 2011, janë vizituar të gjitha familjet e komuniteteve rom dhe ashkalinj dhe është vërtetuar se ata jetojnë në gjendje të vështirë sociale, mirëpo janë veçuar:

Familja e Mursel Bajramit, me 13 anëtarë, jeton në një shtëpi prej materialit të dheut me lagështi shumë të madhe e cila as afërisht nuk i plotëson kushtet për banim. Gjendjen e kësaj familje e rëndon edhe më shumë fëmiju Fidaim Bajrami, 13 vjeçar, i sëmurë që është në terapi të vazhdueshme mjekësore, lidhur me këtë ky kryefamiljar ka kërkuar ndihmë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale por deri më tash nuk ka marrë përgjigje. Gjithashtu ka aplikuar për përfitim në ndërtimin e shtëpisë së karakterit social por kërkesa e tij është refuzuar.

Familja e Nexhat Ramës, me tre vëllezër gjithsej 20 anëtarë, asnjë i punësuar dhe kërkesë e kësaj familje është që së paku njërit prej vëllezërve t'i ndërtohet shtëpia. Gjithashtu kërkojnë ndihmë për fëmijun e Refik Ramës i cili është i sëmurë nga syri dhe trajtimi mjekësor duhet të bëhet jashtë Kosove.

Familja e Alush Bahtirit, 19 anëtarë jeton në ish bufen e Stacionit hekurudhor në gjendje shumë të vështirë.

Familja e Avni Tahirit, 8 anëtarë, nuk posedon as shtëpi e as pronë të paluajtshme.

Familja e Fikrie Ademit, 13 anëtarë dhe asnjë i punësuar jeton në gjendje të vështirë ngase përveç gjërave tjera i mungojnë edhe artikujt ushqimor. Kjo familje jeton nga ndihma sociale mirëpo me këtë nuk mund të siguroj as artikujt ushqimor.

Familja e Naser Ahmetit dhe Azem Ahmetit, jeton në gjendje të vështirë dhe kërkon ndihmë në artikuj ushqimor dhe mundësisht, punësimin e ndonjërit prej anëtarëve të familjes ngase nuk e kanë asnjë të punësuar.

Familja e Salman Lahut, 6 anëtarë, me nënën e moshuar 78 vjeçare jeton me ndihmë sociale dhe kërkon ndihmë me artikuj ushqimor.

Familja e Sylejman Lahut, 8 anëtarë, bashkëshorten 44 vjeçare të sëmurë më shumë se një vit e gjysmë, kërkon ndihmë për shërimin e bashkëshortes por edhe ndihmë në artikuj ushqimor.

Basri Halili, i ka 4 fëmijë në shkollë dhe veçon kërkesën që institucionet e Komunës t'i ndihmojnë në shkollimin e fëmijëve.

Sheqir Rama dhe Flotim Lahu, kërkojnë ndihmë në artikuj ushqimor.

Në fshatin Sfeçël, më 17 mars 2011, janë vizituar:

Familja e Sokol Rexhepit, 8 anëtarë jeton në kushte të vështira sociale, ka aplikuar për ndihmë sociale por kërkesa e tij është refuzuar. Gjendjen e kësaj familjeje e rëndon edhe më tepër fakti se kryefamiljari në një aksident trafiku e ka thyer komblikun e këmbës dhe tani për momentin është i palëvizshëm. Kërkon ndihmë për shërim edhe shqyrtimin e mundësive për përfitimin e së drejtës në ndihmë sociale e mbi të gjitha të merret në konsideratë gjendja e tij shumë e vështirë.

Në fshatin Batllavë, vizitë e bërë më 17 mars 2011, bashkërisht me përfaqësuesin e lagjes Ragip Kovaçin, u vizituan 9 familje dhe u konstatua se shumica e tyre jetojnë nga ndihma sociale, nuk kanë të punësuar dhe se nga kjo lagje 15 nxënës vijnë në mësimet në shkollë fillore.

Vlerësim i grupit që bëri vizitën por edhe komunitetit lokal është se Faton Kovaçi, familje prej 11 anëtarëve nga të cilët 3 nxënës, jeton në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe se rasti i tij duhet të ketë prioritet në ofrimin e ndihmave të ndryshme.

Në fshatin Orllan, më 17 mars 2011, janë vizituar:

Familja e Nysret Kovaçit, 6 anëtarë prej tyre 3 nxënës të shkollës fillore e cila jeton në një shtëpi prej materialit të dobët – dheut. Ka aplikuar për ndërtimin e shtëpisë së karakterit social por kërkesa e tij është refuzuar. Kërkon që gjendja e tij vështirë sociale dhe e strehimit të merret në konsideratë.

Familja e Milaim Halitit, brengën më të madhe e paraqiti ndërprerjen e mësimave të të birit Kemajlit në American High School, për shkak të pamundësisë financiare që të vazhdojë mësimet e mëtejshme. Lidhur me këtë i është drejtuar Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe përmes Komitetit për Komunitete edhe Drejtorisë së Arsimit në Podujevë për ofrimin e ndihmës sipas mundësive, mirëpo nuk ka marrë kurrfarë përgjigje.

Familja e Nazmi Avdiut, 6 anëtarë, jetojnë në kushte shumë të vështira sociale, pa kurrfarë ndihme, gjendje të cilën e vështirëson edhe më shumë sëmurja e kryefamiljarit i cili është i paralizuar dhe kërkon nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale t'i ndihmohet apo së paku t'i mundësohet shërimi në ndonjë banjë, përveç të përmendurit i sëmur është edhe i biri i tij Kenani.

Familja e Bejtullah Kovaçit, 62 vjeçar, me 7 anëtarë, përveç gjendjes së vështirë sociale kryefamiljari dhe bashkëshortja e tij janë në gjendje të vështirë shëndetësore dhe kërkojnë ndihmë për sigurimin e barnave dhe sipas mundësive shërim në ndonjë banjë.

Familja e Gani Bajramit, 5 anëtarë, jeton në gjendje të vështirë sociale dy fëmijë i ka në shkollë fillore ndërsa një në shkollë të mesme, Ganiu dhe bashkëshortja janë të sëmurë dhe është familje të cilës i mungojnë artikujt më elementar për jetesë ngase me ndihmë sociale nuk është në gjendje t'i plotësojë nevojat e shumta.

Familja e Zeqir Avdiut, veçoi brengën dhe shqetësimin për shkollimin e dy nxënësve në shkollë të mesme dhe kërkoi t'i ndihmohet në këtë drejtim.

Brengat dhe shqetësimet e përbashkëta të banorëve në fshatin Orllan

-Mungesa e ujit për pije, përkundër faktit se nga liqeni i Batllavës, me ujë të pijes përveç Prishtinës furnizohen edhe disa Komuna të tjera

-Mungesa e rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza të cilat derdhen në liqe dhe shkaktojnë rrezik për të gjithë ata të cilët atë ujë e përdorin për pije dhe për zgjidhjen e kësaj çështjeje kërkojnë t'iu ndihmohet në mënyrë financiare për hapjen e gropave septike ku do të derdhen ujërat e zeza, kërkesë e cila është shtruar shumë kohë më parë por nuk ka pasur përgjigje.

z. Nebih Behluli, rikujtoi se rasti i z. Kemajl Haliti, nga fshati Orllan, për ndihmë financiare për vazhdimin e vitit të katërt në Shkollën e mesme të lartë Amerikane në Prishtinë, nga ky Komitet është mbështetur pa rezervë dhe i është rekomanduar Drejtorisë së Arsimit të shqyrtojë mundësitë që të përmendurit, sipas mundësive financiare, t'i ndihmohet maksimalisht sa është e mundur, mirëpo pasi nuk i është ofruar kurrfarë ndihme kjo çështje mund të përcillet për shqyrtim edhe

në Komitet për Politikë dhe Financa. Ndërsa sa i përket fëmiut të sëmurë nga syri, tha Drejtorja kompetente nuk ka mjete por për këtë çështje duhet drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë.

z. Burhan Blekçori, theksoi, nga ky raport në veçanti më brengos rasti i fëmiut të sëmurë nga syri, rast i cili duhet të ketë tretman të veçantë andaj ne duhet të shfrytëzojmë të gjitha mundësitë për ofrimin e ndihmës së mundshme.

z. Halil Sylja, lidhur me mosdhënien e përgjegjës nga Drejtorja e Arsimit e cila ka të bëjë me ofrimin e ndihmës për shkollim të Kemajl Halitit në American High School tha, në vazhdimësi duhet të bëhen kërkesat derisa të merret përgjigjja konkrete dhe shtoi sa i përket gjendjes sociale të këtyre komuniteteve është fakt se edhe te pjestarët e komunitetit shumicë për çdo ditë rritet numri i atyre të cilët kërkojnë ndihma të ndryshme.

z. Habil Sylejmani, theksoi, Team Kosova ka ndihmuar dhe është duke ndihmuar, në veçanti në veshmbathje.

Në vazhdim pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua, ky

Konkluzion

I. Miratohet raporti i paraqitur në formë gojore për vizitën e bërë komuniteteve rom dhe ashkalinj në territorin e Komunës së Podujevës.

II. Për mbledhjen e radhës të përgatitet raporti i detajuar në formë të shkruar me rekomandime përkatëse.

6. Të ndryshme

z. Hilmi Sylja, u interesua të dijë se përfaqësuesit e komuniteteve rom dhe ashkalinjë a bashkëpunojnë me Kryqin e Kuq.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, parafolësin e njoftoi se ekziston bashkëpunimi me Kryqin e Kuq dhe shtoi, ky Komitet ka rekomanduar që Zyra për komunitete në Komunën e Podujevës të ketë stafin prej 5 nëpunësve, ndërsa Komiteti për Politikë dhe Financa ka rekomanduar që ajo Zyrë t'i ketë 2 nëpunës, mirëpo unë jam i mendimit se në Zyrën për komunitete duhet të jenë së paku 3 nëpunës në mënyrë që të punësohet ndonjë pjesëtar i komuniteteve pakicë dhe për këtë qëllim kemi vendosur që së bashku me z. Burhan Blakçorin dhe z. Arbresha Hetemjan të shkojmë te kryetari i Komunës për të shqyrtuar këtë çështje.

z. Nebih Behluli, theksoi, komunitetet rom dhe ashkalinj nga ky Komitet janë mbështetur gjithherë dhe jam i mendimit se do të ishte mirë sikur në atë Zyrë të punësoheshin një apo dy pjesëtarë të komuniteteve të cekura.

z. Arbresha Hetemaj, nënvizoi, ne si Komitet gjithherë e kemi shprehur vullnetin dhe gatishmërinë tonë për mbështetje të komuniteteve pakicë, mirëpo jam e mendimit se kryetari i këtij Komiteti nuk është aktiv sa do duhej të ishte.

z. Jahë Lahu, theksoi, në trajnimin e mbajtur në Prishtinë e të organizuar nga OSBE-ja, është dëshmuar se puna dhe angazhimi por edhe Programi i punës i këtij Komiteti është më i miri, por përkundër kësaj te ne në Zyrën për komunitete është paraparë stafi prej dy të punësuarve derisa po e zëmë në Shtime janë paraparë pesë të punësuar.

Në fund dua të falënderoj strukturat komunale për përfshirjen e mirë të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkalinj në Komisionet për regjistrimin e popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare.

Mbledhja përfundoi në orën 12,15.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01/77-06
Podujevë,
8 prill 2011**

**Kyesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**